



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.08.2020 të parashtruar nga Operatori ekonomik "PASTOR KOSOVA" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit", me Nr. të Prok: 632-20-1867-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "PASTOR KOSOVA" sh.p.k, e dt. 07.08.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit", me Nr. të Prok: 632-20-1867-1-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 04.08.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 04.08.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik "PASTOR KOSOVA" sh.p.k, me datë 07.08.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit", me Nr. të Prok: 632-20-1867-1-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.08.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Bazuar në RRUOPP, nëse :

1.Mungon referenca/certifikata e pranimi nga lista e kontratave të prezantuara – Mund të kërkojen informata sqaruese;

- Juve ju mungon lista e kontratave, prandaj nuk ju janë kërkuar informata sqaruese.

2.Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë(referenca/certifikata e pranimi/kontrata) - Mund të kërkojen informata sqaruese.

- Juve ju mungojnë dëshmitë(referenca/certifikata e pranimi/kontrata), prandaj nuk ju janë kërkuar informata sqaruese.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupit të operatorëve ekonomik "TEKNIKU" sh.p.k., i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit, prandaj Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës

Faton Gufaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

